



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 2.2.2024

Lënda: Lidhur me denoncimet për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Çafka, të përcjella nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, pas seancës gjyqësore të datës 26.1.2024

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

1. Pas seancës gjyqësore të datës 26.1.2024, Kolegji i Posaçëm i Apelit, me shkresën nr. **/** prot., datë 26.1.2024, regjistruar në IKP me nr. **/** prot., datë 29.1.2024, ka përcjellë kopje të denoncimeve të shtetasit *** ***, konkretisht:

1.1 *Denoncim i regjistruar në Kolegj me nr. **/**, datë **.1.2024*, ku denoncuesi, shtetasi ***, ***, pretendon se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar shtetasen ***, ***. dhe ka lënë pa zbuluar një ngjarje kriminale, duke mos kryer asnjë veprim hetimor në ngarkim të kësaj të fundit, veprime këto të qëllimta.

1.2 *Denoncim i regjistruar në Kolegj me nr. **/**, datë **.1.2024*, ku denoncuesi, shtetasi ***, ***, pretendon se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur hetimet dhe nuk ka kryer asnjë veprim verifikues, vetëm për faktin që të favorizojë shkelësit e ligjit në një procedim penal të regjistruar për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve dhe shpërdorim detyre ndaj disa mësuesve të gjimnazit “*** **”, në Libohovë.

1.3 Përmbajtja e këtyre dy denoncimeve ka qenë pjesë e denoncimit të datës **.11.2021, nga i njëjti denoncues, të shqyrtuar nga Komisioneri Publik, dhe nuk janë pjesë e ankimit të Komisionerit Publik.

1.4 *Denoncim i regjistruar në Kolegj me nr. **/**, datë **.1.2024*, ku denoncuesi, shtetasi ***, ***, pretendon se subjekti i rivlerësimit, në procedimin penal nr. ***, të vitit 2019, ka favorizuar krimin dhe nuk e ka ndëshkuar atë, edhe pse dëmtohet financiarisht shteti. Përmbajtja e këtij denoncimi është trajtuar edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, ku ky i fundit ka vendosur transferimin e çështjes pranë organit kompetent për inspektim të shkeljeve të mundshme disiplinore, çështje e cila referohet edhe në ankimin e datës 11.11.2021, të Komisionerit Publik, për t’u marrë eventualisht në vlerësim kumulativ, në funksion të gjetjeve të tjera të mundshme të dala nga shqyrtimi i çështjeve, për të cilat është kërkuar hetimi i tyre rishitazi në Kolegj.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA